



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ .03.2023

MBLEDHJA Nr. 11,
Datë 13.03.2023, ora 11:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 13.03.2023, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 11 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s datë 03.03.2023
2. Mbi fillimin e procedurave për disa ndryshime në kontratën tip mbi verifikimin e matësave të energjisë elektrike dhe vulosjen e tyre, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE Nr.164/2016
3. Mbi licencimin e shoqërisë “Natyre Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike
4. Mbi licencimin e shoqërisë “Sun Avenue” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Povelçë, Bashkia Fier
5. Mbi licencimin e shoqërisë “Sunpower 2017” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Povelçë, Bashkia Fier
6. Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Energy24” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI